
UNIVERSITETI
"ALEKSANDËR MOISIU"

DHOMA E TREGTISË
DHE INDUSTRIË

"Bordi Strategjik Këshillimor për Sipërmarrje dhe Inovacion"

BORDI STRATEGJIK KËSHILLIMOR PËR SIPËRMARRJE DHE INOVACION

Bordi Strategjik Këshillimor për Sipërmarrje dhe Inovacion (tani e tutje Bordi) në Universitetit “Aleksandër Moisiu” (UAMD) është një organ këshillimor për orientimin dhe mbështetjen e arritjeve të objektivave strategjike të institucionit. Ky Bord bashkon ekspertizën e shquar në fushën e sipërmarrjes, e kombinuar me ekselencën akademike të Universitetit.

Përbërja e Bordit është më anëtarë të nderuar që vijnë nga biznese të mëdha në Durrës dhe në Shqipëri. Anëtarët janë zgjedhur bazuar në përvojën e tyre të drejtpërdrejtë të menaxhimit të kompanive dhe projekteve të mëdha dhe konsiderohen nga Universiteti si palë e rëndësishme dhe aktorë kontribues në përmbushjen e misionit të tij. Qasja strategjike, ekspertiza dhe kontributi i tyre do t'i shërbejë institucionit, komunitetit dhe gjithë vendit.

Bordi do të përbëhet nga 15 anëtarë, të cilët do të angazhohen në mënyrë aktive në fushat si më poshtë vijon:

- tregu i punës dhe sipërmarrja;
- përshtatja e kurrikulave mësimore në përputhje me nevojat e tregut dhe përgjigjen me fleksibilitet dhe shpejtësi ndaj këtyre ndryshimeve, jo vetëm në shkallë lokale, por edhe në shkallë kombëtare;
- aplikim dhe zbatim të projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore dhe zhvillimore me impakt rajonal e kombëtar;
- organizim të forumeve, konferencave dhe aktiviteteve të tjera me interes të përbashkët, etj.;
- mundësim për praktika studentore.

PËRSE NJË BORD?

Bashkëpunimi i qëndrueshëm dhe efektiv i trekëndëshit universitet - biznes - komunitet. Marrëveshjet e nënshkruara mes universitetit dhe kompanive, nevojiten të vitalizohen. Shpesh, duhet angazhim konkret dhe përkushtim nga të gjitha palët, për të zbatuar marrëveshjet me plane konkrete veprimi në kuadër të bashkëpunimeve. Angazhimi në një strukturë të posaçme, e cila do të orientojë e mentorojë zbatimin e marrëveshjeve është një mundësi për të krijuar ura të reja dhe efektive bashkëpunimi.

Zbulimi i talentit. Avantazhet e të pasurit një Bord këshillimor pranë universitetit mund të rrisë përfitimet për të dyja palët dhe ndihmojë në evidentimin, promovimin dhe mbështetjen e talenteve duke i shërbyer kështu individit dhe shoqërisë.

Kultivimi i institucioneve, jo vetëm individëve. Përmes këtij Bordi duam të ndërtojmë një model të qëndrueshëm bashkëpunimi, që u mundësojnë kompanive të qëndrojnë të lidhura me universitetin në mënyrë që të nxisin marrëdhënie kërkimore afatgjata, për projekte specifike me interes të gjerë zhvillimor. Pra, Bordi do të shërbejë për zhvillimin e institucionit përmes bashkëpunimit të ngushtë në fusha dhe interesa specifike në përfitim të institucionit dhe komunitetit.

Puna me partnerë të jashtëm na lejon të dyja palëve të kemi qasje në mundësi të reja zhvillimore. Universiteti ofron kapacitete të madha kërkimore shkencore, hapësirë talentesh dhe aftësish, ndërsa biznesi fleksibilitet dhe njohje praktike.

Investim në marrëdhëniet afatgjata. Akademia dhe sipërmarrja duhet të jenë realistë në lidhje me pritshmëritë e tyre për rezultate të shpejta të nismave të tilla. Këto të fundit duhet të mbështeten në programe të gjata dhe të vazhdueshme bashkëpunimi në mënyrë që të japin rezultatet e duhura.

NDRYSHIMET QË PRESIM

Ky bashkëpunim i hulumtuesve dhe botës së biznesit ka potencialin për të **ofruar zgjidhje** për disa nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet sot shoqëria shqiptare.

Ky Bord do të ndihmojë në **shkëmbimin e inovacionit, ideve, aftësive dhe burimeve njerëzore** me qëllimin për të patur zhvillim të njëkohësishëm të institucioneve tona, njëherazi edhe të komunitetit.

Portfolio i projekteve kërkimore dhe zhvillimore të UAMD-së, financuar nga Bashkimi Europian, do t'i shërbejë forcimit të bashkëpunimit mes institucionit, biznesit dhe komunitetit, nëse palët shfaqin përkushtim. Tipologjia e projekteve aktuale në UAMD-së është e një game të gjërë, që varion nga inovacioni dhe teknologjia tek ekonomia blu dhe tregu i punës.

UAMD përmes BE-së po ndërton një hapësirë (**HUB**) për grupe inovacioni, startup, OJQ, dhe biznesin për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe për të kontribuar për zhvillimin e inovacionit në komunitet dhe vend.

UAMD ka një **laborator Multimedia** me pajisjet më të fundit teknologjike, që mund t'i vijë në ndihmë promovimit të biznesit në Durrës, sidomos në fushën e turizmit.

Konsulenca e ekspertëve tanë mund t'i shtojë vlerë biznesit apo organizatës suaj. Nga ana tjetër, njohja e gjërë e klimës dhe natyrës së biznesit dhe puna e përbashkët do të shtonte impaktin e të dyja palëve në shoqëri.

Ne kemi mundësinë që t'ju ofrojmë studentëve **mundësi praktikash pranë bizneseve**. Karriera dhe Alumni në UAMD do të fuqizohet përmes këtij bashkëpunimi për t'ju ofruar studentëve mundësi rritjeje profesionale dhe individuale pranë bizneseve përgjatë studimeve dhe pas tyre. Nga ana tjetër, sipërmarrja mund të të përfitojë nga studentë me kapacitet dhe talent.